

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master Profesional në:


Infermieri Kirurgjikale

Ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Asoc. Dr. Manika KREKA

Dr. Brizida REFATLLARI



(Qershor / 2019)


RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në: Infermieri Kirurgjikale”

Ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Mjekësore
3	Urdhëri/VKM i licencimit Urdhëri i riorganizimit	Urdhër Nr.479 date 10.10.2012/ Vendim Senati Nr.6, date 28.02.2018, miratuar nga MASR me shkresë Nr. 6313/2, datë-18.07.2018
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	VBA Nr. 32, datë 19.05.2017, i ndryshuar me VBA Nr. 32/2, date 02.02.2018
5	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesëshe/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7 (shtatë)
16	Numri i studentëve për programin e studimit	152

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL



Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin e jashtëm të Programit të Studimit Master Profesioanl në “Infermieri Kirurgjikale” ofruar nga Universiteti Privat “ Albanian University. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kompetencën e stafit pedagogjik, etj. Programi në fjalë ofrohet nga Departamentit i Infermierisë dhe Fizioterapisë pranë Fakultetin e Shkencave Mjekësore.

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2010 me emërtimin Departamenti i Infermierisë, si pjesë e Fakultetit të Stomatologjisë. Në vitin 2013, Fakulteti i Stomatologjisë, ndryshon emërtim duke u quajtur “Fakulteti i Shkencave Mjekësore” i riorganizuar me 3 departamente, 1 Klinikë Universitare dhe 1 Qëndër Kërkimore.

1. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë,
2. Departamenti i Farmacisë,
3. Departamenti i Stomatologjisë.
4. Klinikë Universitare
5. Qëndër Kërkimore

Po në këtë kuadër të riorganizimit, Albanian University ndërmer një ndryshim të emërtimit të Departamentit, në “Departament i Infermierisë dhe Fizioterapisë”. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë zhvillon aktivitetin e tij në tre godina, përkatësisht në Godinën e Ish-Gjykatës, rruga e Durrësit, Godina e Ish-Estradës, Blv. Zogu i I-rë, si dhe Godina e Internacionalit, rruga Kajo Karafili.

Programi i studimit Master i Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.479., datë 10.10.2012. Ky Master ka qënë i organizuar në 90 ECTS, me një kohëzgjatje prej 1,5 vite akademike. Masteri Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” iu nënshtrua procesit të parë të akreditimit në vitin akademik 2015-2016, në përfundim të të cilit u akreditua me kusht në bazë të Urdhërit Nr.242, datë 09.05.2016. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë u angazhua në menyrë aktive në plotësimin e kushteve të parashtruara nga grupi i vlerësimit të jashtëm, dhe në vitin akademik 2016-2017, Programi i Studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” u akreditua me Vendim të Bordi të Akreditimit Nr.32, datë 19.05.2017, vetëm për studentët e regjistruar deri në vitin akademik 2016-2017, me kusht që të mos pranohen studentë të rinj deri në riorganizimin e këtij masteri. Ky vendim u pasua nga një vendim i dytë i Bordi të Akreditimit Nr.32/1, datë 15.12.2017, në të cilin bëhet një ndryshim i pikës 2 të Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.32 datë 19.05.2017. Ky vendim u pasua me një Vendim të tretë të Bordit të Akreditimit Nr.32/2, datë 02.02.2018 në të cilin specifikohet akreditimi dhe për brezin 2017-2018 deri në diplomimin e tyre.

Në kuadër të dispozitave të reja ligjore, përkatësisht Udhëzimi Nr.31, datë 29.12.2017 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, propozoi ngritjen e grupit të punës, për riorganizimin e Master Profesional ne “Infermieri Kirurgjikale” në përputhje me dispozitat e reja ligjore . Programi i studimit *Master i Profesional* në “Infermieri Kirurgjikale” i riorganizuar në 60 ECTS është riorganizuar me miratim të Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 28.02.2018,dhe miratuar nga MASR me shkresë Nr. 6313/2 prot datë 18/07/2018.

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në fillim të çdo viti akademik angazhohet në përmirësimin e syllabuseve në përmbajtje dhe literaturë (brenda limitit 20% të lejuar nga legjislacioni), në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimet më të fundit teknologjike.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Prof.As. Manika Kreka

Dr. Brizida Refatllari

GVJ është asistuar gjatë gjithë procedurës nga specialistja e ASCAL, Msc. Majlinda Demirneli.

Universiteti Privat “Albanian University” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 31.05.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 8/4 Prot, datë 03.06.2019. Universiteti Privat “Albanian University” përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 347/1 Prot, datë 10.06.2019 komente në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

Për Komentin e parë, institucioni shprehet se:

Për sa i përket literaturës së rekomanduar, e cila është konsideruar si e vjetër, dëshirojme të theksojmë që pedagogët përkatës këshillojnë literaturë bashkëkohore të rekomanduar të bibliotekave online, duke pajisur studentin me të rejat e fundit në fushën përkatëse.

Në lidhje me përgjigjen e dhënë nga Institucioni mbi literaturën e rekomanduar, e cila është konsideruar e vjetër nga GVJ, dëshirojmë të theksojmë se pavarësisht faktit që pedagogët u këshillojnë literaturë bashkëkohore të rekomanduar të bibliotekave online, **është e detyrueshme** që në syllabus ta përshkruajnë këtë literaturë, të cilën ata si ekspertë të fushës e shikojnë të përshtatshme për studentët. Literatura e rekomanduar që pedagogët kanë përshkruar në syllabus nuk është në përputhje me literaturën bashkëkohore për t’i pajisur ata me të rejat në fushën përkatëse. **GVJ-ja i qëndron vlerësimit të shprehur në raport.**

Për Komentin e dytë, institucioni shprehet se:

Për sa i përket mos pasqyrimit të lëndës “Etikë Mjekësore” në tabelën e planit mësimor lidhur me personelin akademik përkatës të këtij programi, dëshirojmë të theksojmë që kjo lëndë nuk është pasqyruar, pasi për vitin akademik 2018-2019 studentët kanë zgjedhur të zhvillojnë nga 3 lëndët me zgjedhje, vetëm Sociologji Mjekësore dhe Psikologji Mjekësore. Pra lënda “Etikë Mjekësore” nuk është zhvilluar këtë vit akademik.

Në lidhje me përgjigjen e dhënë nga Institucioni, dëshirojmë të theksojmë që GVJ i është referuar Planit Mësimor të vitit akademik 2018-2019, të paraqitur në RVB dhe dokumentacionin e Institucionit, në të cilin është pasqyruar dhe moduli “Etikë mjekësore”. Rrjedhimisht edhe Plani Mësimor i lidhur me Personelin Akademik përkatës për vitin akademik 2018-2019 duhet t’i përshtatet këtij dokumentacioni, i cili dorëzohet në fillim të vitit akademik, pavarësisht përzgjedhjes së bërë nga studentët. **GVJ-ja i qëndron vlerësimit të shprehur në raport.**

Për Komentin e tretë, institucioni shprehet se:

Departamenti në bashkëpunim me pedagogun përkatës garanton përmisimin e syllabusit “Etikë Mjekësore” për të sjellë tematika më informuese dhe selective për studentët që ndjekin ciklin e dytë të studimeve në këtë program studimi.

GVJ mbështet komentin e bërë nga Institucioni mbi bashkëpunimin e Departamentit me pedagogun përkatës për të garantuar përmirësimin e këtij syllabusi me tematika më informuese dhe selektuese për studentët e programit. **GVJ-ja i qëndron vlerësimit të shprehur në raport.**

Për Komentin e katërt, institucioni shprehet se:

Departamenti garanton angazhimin e pedagogëve në Rishikimin e emërimit të lëndëve/moduleve në përputhje me profilin e pedagogut përgjegjës për secilën lëndë.

GVJ, mbështet angazhimin e Departamentit në lidhje me përmbushjen e tij. **GVJ-ja i qëndron vlerësimit të shprehur në raport.**

Për Komentin e pestë, institucioni shprehet se:

Departamenti ju dërgon Rregulloren e azhornuar, duke korigjuar “lapsusin” e emërimit e modulit “Menaxhim infermieror” duke e zëvendësuar me modulin “Promocion shëndetsor”.

Theksojmë se GVJ në këtë fazë nuk mund të pranojë dokumentacion nga ana e Institucionit. Megjithatë pranojmë korigjimin e bërë nga Departamenti duke e cilësuar si “lapsus” të emërimit të modulit “Menaxhim infermieror” dhe zëvendësimin e tij me modulin “Promocion shëndetësor”.

GVJ-ja reflekton ndryshimin të shprehur në raportin final.

Për Komentin e gjashtë, institucioni shprehet se:

Institucioni dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, ka si stretegi afatshkurtër që të rrisë angazhimin dhe përfshirjen e personelit akademik në programme shkëmbimi apo projekte ndërkombëtare, në funksion të kualifikimit të stafit akademik dhe rritjes së cilësisë së miësimdhënies.

Në lidhje me përgjigjen e dhënë nga Institucioni GVJ mbështet komentin e bërë nga Institucioni mbi strategjinë afatshkurtër të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë duke u angazhuar në përmbushjen e kësaj pike. **GVJ-ja i qëndron vlerësimit të shprehur në raport.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Në përputhje me axhendën e hartuar, gjatë vizitës dy ditore ne institucion, u njohëm edhe njëherë me këtë program studimi që ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë. Të përgatisësh infermierë për të punuar në salla kirurgjikale apo edhe qendra shëndetësore ku ofrohet mikrokirurgji sot është një sfidë dhe një nevojë e shoqërisë sonë. E pikërisht ky program studimi i ofruar prej vitesh përmbush më së miri këtë mision dhe strategji të Institucionit. Ky program i nivelit të dytë të studimeve, ofrohet në përputhje me objektivat kombëtarë, ndërkombëtarë. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij dhe mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike për arsye të karakterit të mirëfilltë profesional të tij dhe njohurive nga fusha e infermierisë kirurgjikale, duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin e mëtejshëm të studentëve për punësim duke ndjekur njëkohësisht edhe politika favorizuese për punësimin e të diplomuarve. Ky program studimi, tashmë me 60 kredite, ka një kurrikul të pasur dhe të update-uar. Ky Program studimi mbështetet në përvojën disavjeçare dhe praktikat më të mira të vendeve europiane. Biseda në Institucion me një pjesë të stafit akademik dhe jo vetëm, e konfirmoi më së miri këtë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit MP në Infermieri Kirurgjikale është hartuar plotësisht në përputhje me misionin dhe qëllimin e Albanian University.</p> <p>Ky program studimi është hartuar duke vlerësuar nevojat e tregut të punës për infermierë në salla kirurgjikale në qendra terciare, sekondare, por edhe në qendra të kujdesit shëndetsor</p> <p>Bazuar në planin startegjik institucional 2017-2022, në planin strategjik të Fakultetit të Shkencave Mjekësore 2017-2018, programi i studimit Mp. në Infermieri Kirurgjikale përputhet plotësisht me misionin e Albanian University, për një arsim cilësor universitar, edukim me vlerat më të mira morale, zhvillimin e kërkimit shkencor, me qëllim që të sigurojë formimin e specialistëve të aftë profesionalisht.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me	Programi i studimit Mp. në Infermieri Kirurgjikale

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

<p>strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>është hartuar duke u mbështetur në strategjinë e zhvillimit të Albanian University në fushën e infermierisë.</p> <p>Strategjia për zhvillim e këtij institucioni kërkonte edhe fillimin dhe riorganizimin e këtij programi në fushën kirurgjikale në shërbim të adultëve dhe fëmijëve.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit Mp. në Infermieri Kirurgjikale është hartuar në përputhje me gjithë legjislacionin në fuqi, si Ligji 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore.</p> <p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka riorganizuar këtë program studimi në përputhje me Ligjin e Arsimin të Lartë Nr.80/2015 dhe VKM 41, datë 24.01.2019.</p> <p>Sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit, në përputhje me nivelin 7 të kualifikimeve ky program i Masterit profesional i përmban të gjithë elementët akademikë si program i nivelit të dytë duke përgatitur në fund të studimeve infermierë të aftë për të gjitha nivelet e punësimit në fushën infermiore.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University”, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave në bashkëpunim me NjSBC ka realizuar përditësimin e syllabuseve për Mp në Infermieri Kirurgjikale.</p> <p>Programi është hartuar e programuar për zhvillim në mënyrë që studentët të kenë lirinë akademike, por edhe mësidhënia e mësinxënia të realizohen kundrejt gjithë niveleve të pranueshme në mënyrë sa më cilësore. Programi është hartuar duke integruar mësimdhënien teorike me atë praktike.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>1. Programi i studimit Mp në “Infermieri Kirurgjikale” është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të Albanian University si dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në fushën e infermierisë.</p>	

2. Programi përmban një plan mësimor të mirëstrukturuar .
3. Departamenti punon vazhdimisht duke përmirësuar kurrikulat dhe planet mësimor (para fillimit të çdo viti akademik, studiohen kurrikulat ekzistuese dhe përshtaten ato, me synim për të pajisur studentët me maksimumin e dijeve, duke ndryshuar kurrikulën deri në masën 20%, sipas kërkesave të departamentit). Çdo gjë bëhet për përmirësimin e vazhdueshëm në drejtim të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Albanian University, pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.52, datë 5.02.2016 të MAS, përbëhet nga tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;

3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore

AU ofron programe studimi për të tre ciklet e studimit si dhe realizon kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njësisë përbërëse. Programi i studimit Mp në “Infermieri Kirurgjikale” është organizuar nën drejtimin e Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë, të Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Fakulteti drejtohet nga Dekani. Sipas Statutit, Dekani i Fakultetit propozohet nga Rektori dhe emërohet nga Senati Akademik mbi bazë të një procesi konkurimi.

Organ kolegjal drejtues i Fakultetit është Dekanati, i cili drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga Dekani, Zv.Dekani, Administrator i Njësisë Kryesore dhe Drejtuesit e departamenteve.


Fakulteti i Shkencave Mjekësore përbëhet nga tre departamente:

- **Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë**
- Departamenti i Farmacisë
- Departamenti i Stomatologjisë

Fakulteti në vitin aktual akademik **2018-2019** ka në përbërjen e tij **179** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **106** persona, nga të cilët 57 janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej **73**, nga të cilët 49 me tituj/grada. Personel administrativ janë 55 personel.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në vitin aktual akademik 2018-2019 ka në përbërjen e tij **95** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **52** persona,



nga të cilët 16 janë me tituj/grada , ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej 43, nga të cilët 10 me tituj/grada.(

Standardi/Kriteret“	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Albanian University, pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.52, datë 5.02.2016 të MAS, përbëhet nga tre njësi kryesore:</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore</p> <p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</p> <p>Fakultetet e tij janë të organizuara në njësi bazë, departamente, që do të thotë: Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka tre departamente, Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka katër departamente dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka tre departamente. Objektivat e të tre njësisive bazë janë të përcaktuara në rregulloret e departamenteve përkatëse.</p> <p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë që ofron këtë program studimi, në respekt të Ligjit dhe Udhëzimeve, ka në përbërjen e tij 52 pedagogë efektivë, nga ku: 4 pedagogë janë me titullin Prof.Dr, 2 kanë titullin Prof. Asoc., 10 janë me gradën shkencore Dr. 8 janë me Spa, 27 me Msc dhe 1 me MP.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësia kryesore dhe tre njësitë bazë zhvillojnë një aktivitet të dukshëm cilësor akademik dhe kërkimor shkencor në përputhje me strategjinë si dhe objektivat e zhvillimit të Institucionit, në funksion të mësimdhënies dhe përgatitjes sa më cilësore të studentëve. Ky Departament në bashkërendim me Fakultetin në përputhje të plotë me Rregulloren Institucionale, në fillim të çdo viti akademik, por edhe në fillim të semestrit të dytë i paraqet Dekanatit kërkesat për personel akademik efektiv dhe me kontratë, me synim plotësimin e vendeve</p>

vakante. Komisioni i vlerësimit të dosjeve ad hoc i ngritur në departament me përfaqësues edhe nga dekanati, vlerëson kriteret e kandidatëve dhe shpall listat e fituesve.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Albanian University, pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.52, datë 5.02.2016 të MAS përbëhet nga tre fakultete. Struktura organizative është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe e ndihmon të realizojë misionin e tij.
2. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë plotëson kriteret si për personelin akademik në total, ashtu edhe për kërkesat në lidhje me kualifikimin e tij.
3. Pedagogët efektivë dhe me kontratë ftohen të konkurrojnë në përputhje me vendet vakante të shpallura nga departamenti në fillim të çdo viti akademik dhe/ose në fillim të semestrit të dytë. Nëpërmjet një konkursi me dosje aplikantësh përzgjidhen kandidatët fitues dhe lidhin kontratën sipas rastit.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raportet PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Për vitin akademik 2018-2019 në përputhje me vendet vakante dhe ngarkesën në orë mësimore akademike rezultojnë që janë të angazhuar në nivel departamenti: 52 pedagogë efektivë dhe 43 pedagogë me kontratë.

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është: **18 PAE, nga ku 13 me tituj/grada dhe 9 PAK nga ku 7 me tituj/grada**, dhe në shërbim të pedagogëve dhe studentëve janë 7 personel administrativ.

Raporti PAE/PAK në këtë program për vitin akademik aktual është **18/9**.

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë program për vitin akademik aktual (2018-2019) është **18 / 27 = 67 %**.

Raporti Personel Akademik / Student në këtë program për vitin akademik aktual është **27/152**

Raporti Personel Administrativ / Student në këtë program për vitin akademik aktual është **7/152**

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Personeli akademik mësimdhënës ka tituj dhe grada shkencore dhe ky raport ka ardhur në rritje. Aktualisht ka 4 pedagogë me tituj shkencorë (Prof dhe Prof. As.), 12 pedagoge me gradë shkencore (Dr./PHD), 4 pedagogë me SPA dhe 7 pedagogë me MSc.

Të dhënat sipas seksit

Për vitin akademik 2018 – 2019 raporti meshkuj/femra për këtë program studimi është **10/17**.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Dominon moshja e personelit midis 36-55 vjeç, gjë që tregon se stafi ka një eksperiencë dhe maturi në punë (e mbështetur edhe nga dosjet e depozituara në Zyrën e Burimeve Njerëzore).

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi administrativ në nivel departamenti ka 7 anëtarë.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat


Pedagogët janë rekrutuar në fillim të çdo viti akademik (në këtë rast në fillim të vitit akademik 2018-2019) dhe me vendim Senati Akademik pas kërkesës së përcjellë nga Departamenti në Dekanat e më pas në Rektorat, ku përcaktohen kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve. Kandidatët e përzgjedhur i nënshtrohen periudhës së provës 3 mujore, në fund të së cilës do të përcaktohet nëse kjo marrëdhënie do të vazhdojë apo do të ndërpritet. Marrëdhënia e punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit rregullohet me anë të kontratës së punës, e cila hartohet me përpikmëri në përputhje me kodin e punës dhe Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Kontratat që nënshkruhen me pedagogët efektivë dhe ata me kontratë administrohen nga zyra e Burimeve Njerëzore e cila është përgjegjëse jo vetëm për arkivimin e dokumentacionit dhe ruajtjen e tij në vite, por edhe për gjenerimin e statistikave vjetore. Në fillim të secilit vit akademik/semestër zyra e burimeve njerëzore bën përditësimin e informacionit mbi stafin akademik. Gjatë vizitës në Institucion u panë disa kontrata të pedagogëve të rinj të rekrutuar. Ishin sipas një standardi të caktuar dhe të firmosura në momentin e pas përzgjedhjes nga konkursi, të firmosura nga dy palët.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit

Për këtë program studimi nuk ka një këshill shkencor, Programi i Studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për	



përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;

Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Të gjithë anëtarët e stafit akademik, atij ndihmës, si dhe atij administrativ reflektojnë aftësitë e nevojshme për të përmbushur misionin në funksion të mësimdhënies, të rritjes së kapaciteteve formuese të studentëve në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Performanca e angazhimit vlerësohet nga vlerësimet e Përgjegjësit të Departamentit dhe mbledhjet e departamentit, në të cilat diskutohet dhe bëhen rekomandime për përmirësime të nevojshme në arritjen e objektivave dhe realizimit të strategjisë së departamentit.

Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.

Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

I gjithë personeli akademik dhe ndihmës e sidomos Grupi i Sigurimit të Cilësisë i ngritur në nivel departamenti, çdo fillim viti është plotësisht i angazhuar në drejtim të rishikimit dhe përditësimit të kurrikulave. Çdo fillim viti stafi akademik angazhohet në rishikimin e syllabuseve në përputhje me kurrikulat, përditësimin e literaturës së përdorur, kjo gjë në bashkëpunim me lektorët e lëndëve dhe moduleve. Në mbledhje të posaçme në departament ata japin mendimet dhe vendosin për t'i përcjellë më pas këto kurrikula në Dekanat e Rektorat.

Departamenti i Infermierisë dhe Fiziotherapisë në përputhje me Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore shpall vendet vakante në raport me ngarkesën mësimore të lëndëve sipas programeve të studimit. Këto vende i përcillen Dekanatit, i cili hap procedurat e rekrutimit me kriteret e miratuara në Senat dhe Rektorat.

Ngarkesa mësimore e stafit akademik efektiv dhe me Kontratë e miratuar në Senat Akademik është në përputhje me nevojat e njësisë bazë.

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të DVV si dhe vizitës në institucion na rezultoi se, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në përputhje me rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, çdo vit akademik bazuar në nevojat për personel akademik i paraqet Dekanatit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante.</p> <p>Për t'u theksuar është se këtë vit akademik (sikurse vjet) procedura e rekrutimit u hap dhe përpara fillimit të semestrit të dytë, pra dy herë në vit.</p> <p>Vendet e punës për personelin akademik publikohen në faqen zyrtare dhe mjete të tjera të komunikimit të institucionit.</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019 personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit përkundrejt personelit akademik me kontrate është në raportin 18/9 duke përbërë 67% të personelit akademik në total.</p> <p>Për sa i përket ngarkesës, pjesa më e madhe e lëndëve mbulohet nga PAE, 1087.5 orë të realizuara nga PAE dhe 412.5 orë të realizuara nga PAK.</p> <p>Pra PAE mbulon 73% të orëve të këtij programi mësimor.</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë/pjesëshme si dhe stafi drejtues kanë një ngarkesë mësimore në përputhje me nevojat e njësisë bazë.</p> <p>Procesit i rekrutimit nga ana e institucionit ka qenë transparent, kjo e mbështetur me shkresa ku ka afate në shpalljen e vendeve, por edhe kritere që respektohen. Kandidatët janë informuar vazhdimisht për ecurinë e konkurrimit dhe momentin kur janë shpallur fitues, janë njohur me detyrimet dhe të drejtat e tyre në këtë institucion të AL.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u njohëm me të gjitha dosjet e aplikantëve dhe të individëve të rekrutuar (kontrata të përshërshme dhe të përkohshme).</p>
---	---

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit është njëkohësisht edhe përgjegjës i programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale". duke organizuar e drejtuar të gjitha hallkat e mbarëvajtjes së ecurisë së këtij programi. Dr.Xhejni Borshi mban gradën</p>
--	---

<p>shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>shkencore “Doktor” (“PhD”) të mbrojtur në Itali. Është specialiste në fushën e Farmaceutikës.</p> <p>Në të njëjtën kohë, koordinatorët e grup-lëndëve të programeve që Departamenti mbulon, mbajnë gradën shkencore “Doktor” dhe “Prof.Asoc.”</p> <p>Të gjithë Titullarët e grup-it (të cilët i takuam në institucion) të angazhuar në këtë program studimi i ofruar nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, janë: një pjesë Prof. Asoc. Dr., edhe lektorët janë një pjesë Prof.As, një pjesë e tyre me Dr. dhe Msc. Të gjithë kanë një përvojë më shumë se 5-vite eksperience.</p> <p>Rektori, zv/rektorët, dekani dhe përgjegjësi i departamentit janë pjesë e stafit akademik me kohë të plotë të Institucionit, ata emërohen sipas rregullores së përcaktuar të Albanian University.</p> <p>Ky Universitet ka marrëveshje bashkëpunimi ku studentët kryejnë praktikën mësimore në përputhje me kalendarin e shpallur. Për çdo grup ka një tutor që drejton praktikën, ai kontrollon dhe mbikëqyr, më pas informon për mbarëvajtjen e saj duke plotësuar fletoren e praktikave për çdo student.</p>
---	--

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” mund të diplomohen me anë të provimit përfundimtar të formimit, ose punimit të një Diplome. Kjo gjë është e përcaktuar në rregulloren e këtij programi studimi.</p> <p>Janë realizuar të parat tema diplome për vitin akademik 2017-2018, kjo për studentët më të mirë, ndërsa për të tjerët i janë nënshtruar një provimi formimi.</p> <p>Mbrojtja e temave të diplomës është bërë për studentët e masterit. Është e përcaktuar në Rregullore, që një udhëheqës që drejton një student, i cili bën një punë kërkimore në fushën e shkencave mjekësore duhet të ketë të paktën Gradën “Doktor” dhe në të njëjtën kohë nuk mund të ketë më shumë se 5 studentë.</p>
---	---

Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Vlen të theksohet që fusha e veprimtarisë kërkimore ku hulumton studenti dhe paraqet temën e diplomës është në përputhje me fushën ku punon pedagogu udhëheqës.</p> <p>Udhëheqësi mbështet me njohuritë e tij të thella dhe të avancuara në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Shqyrtimi i DVV provon (si edhe takimet në Institucion) që ky Institucion angazhon personel ndihmës akademik: me karakter mësimor dhe me karakter administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p> <p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka në përbërje të tij anëtarë të personelit ndihmës-akademik me eksperiencë të gjatë në fushat përkatëse, të cilët jo vetëm realizojnë praktikën në laborator (në auditor), por dhe mbikqyrin praktikën profesionale jashtë auditorit.</p> <p>Ka 5 sekretare mësimore dhe 3 asistente departamenti, të cilat mbështesin çdo ditë punën në këtë departament ku ofrohet edhe ky program studimi.</p>
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Si Personeli akademik me kohë të plotë, ashtu edhe ai me kohë të pjesshme, në të njëjtën kohë stafi drejtues janë të angazhuar të plotësojnë një ngarkesë mësimore në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe nevojat e njësisë bazë.</p> <p>Ngarkesa mësimore në këtë program matet me orë mësimorë akademike sipas Udhëzimit përkatës të MASR. Ka pedagogë që kanë ngarkesë mesatarisht 60-75 orë në auditor, por ka edhe pedagogë që mbulojnë ngarkesë 135 dhe 150 orë akademike në auditor.</p>

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore janë të arshivuara dosjet me të dhëna për të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe ndihmës akademik. Këto të dhëna përfshijnë gradat dhe titujt, CV-të, kontratat, ngarkesën dhe detyrat që kryejnë, si dhe dokumentacionin ligjor të nevojshëm për punësim.

Institucioni ruan ngarkesën mësimore për çdo anëtar dhe e specifikon sipas semestrave.

Transparenca e Zyrës së Burimeve Njerëzore në AU realizohet duke publikuar vendet vakante dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion pune vakant në faqen e internetit, si dhe në mjetet e tjera të informimit publik.

(<http://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-2/>)


Konkluzionet e vlerësimit:

1. Para fillimit të çdo viti akademik është e rëndësishme të nënvizohet se në përputhje me Ligjin dhe udhëzimet e tij, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë bazuar në nevojat për personel akademik i paraqet Dekanatit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante. Zyra e Burimeve Njerëzore në AU publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit në faqen e internetit, si dhe në mjetet e tjera të informimit publik. Vendet e punës për personelin akademik në AU fitohen nëpërmjet një procedure konkurruese dhe nënshkruhen kontratat përkatëse rast pas rasti.
2. Institucioni ka angazhuar personel ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe administrativ për të realizuar mbarëvajtjen e programeve të studimit që ofron.
3. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën 67% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit, ndërsa pjesa e përket ngarkesës mësimore të realizuar, ajo mbulohet në masën 73% nga personeli akademik efektiv. Praktika Profesionale, jashtë auditorit, zhvillohet gjatë semestrit të dytë të vitit akademik, në institucionet me të cilat Departamenti disponon marrëveshje bashkëpunimi, si Spitali “Shefqet Ndroqi”, Materniteti “Mbretëresha Geraldinë” etj.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.



Gjatë vizitës në institucion ne u vizituan mjediset ku studentët ndjekin studimet në këtë program studimi, zhvillojnë leksionet dhe praktikat laboratorike në tre godina, përkatësisht në godinën e ish-Gjykatës në rrugën e Durrësit, godina e ish-Internacionalit në rrugën “Kajo Karafili” dhe godina e ish-Estradës, e cila ndodhet në Bulevardin Zogu i I-rë. Godinat kanë lehtësisht akses me njëra-tjetrën. Sipërfaqja totale e mjediseve (e mbështetur në planimetrinë e godinave) është rreth 4102 m². Mjediset janë të rikonstruara, të ndriçuara dhe të pajisura mjaft mirë me gjithë infrastrukturën e nevojshme. Ofrohet interneti *wireless* kudo. Biblioteka e Fakultetit është e hapur çdo ditë nga e hëna në të premte 8.00 – 16.00 dhe ditën e shtunë 8.00 – 12.00. Labororet e instaluar në të gjitha godinat ofrojnë të gjitha facilitetet për studentët e Masterit Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset në funksion të Programit të studimit në rang Fakulteti:

- Salla për leksione: 2
- Klasa për seminare: 3
- Salla për aktivitete promovuese 1
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale 10
- Laboratorë për lëndët: 1
- Laboratorë informatike: 1
- Salla interneti: 1
- Salla për bibliotekë: 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj: 3
- Zyra informacioni për studentët: 1
- Nyje hidrosanitare : 8

Mjediset për stafin (sipas RVB)

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 2
- Zyra për sekretarinë mësimore 1
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore 4
- Zyra për personelin akademik 3

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedisje janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p>	<p>Në vitin 2010, pranë Albanian University kanë filluar programet e Infermierisë dhe Fizioterapisë, të cilët mbështeten nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë. Studentët vijnë mësimin në auditor qysh prej asaj kohe e në vazhdim në mjediset e ish-Gjykatës së Tiranës në rrugën e</p>

<p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Durrësit.</p> <p>Këto mjedise janë marrë me qera dhe vijnë të jenë të tilla, së fundi në përputhje me një kontratë 10 vjeçare.</p> <p>Të gjitha programet e studimit që ky departament ofron, zhvillohen në tre godina (të përmendura më lart).</p> <p>Është për t'u theksuar se ka marrëveshje me shumë institucione publike si ASHR, OSHK (për shërbimin parësor) si edhe Spitalin e Traumës, në mënyrë që studentët të kryejnë lirisht praktikat klinike profesionale. Në disa raste ka bashkëpunime dhe me spitale rajonale aty ku mentorët mund të ofrojnë mbështetje për studentët (në pamundësi për të qëndruar në Tiranë). Vazhdimisht punohet për të shtuar rrjetin e bashkëpunimit. Praktikantët mësimorë pranë këtyre institucioneve kanë dëshmuar që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e tyre.</p>
--	---

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Formimi teorik është i një vlere kryesore për studentët e FSHM dhe konkretisht ata të Masterit Profesional në Infermieri Kirurgjikale. Për këtë gjithmonë biblioteka është plotësuar me literaturë të vendit dhe të huaj, qoftë kjo e detyruar, qoftë edhe ndihmëse e rekomanduar.</p> <p>Numërohen rreth 330 tituj librash (në total për të gjithë studentët) me një tirazh prej 1314 kopje. <i>Literatura ka nevojë të përditësohet në përputhje me lëndët kurrikulare.</i></p> <p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore vë në dispozicion të studentëve të Infermierisë dhe Fizioterapisë rreth 145 tituj librash në fushën e Infermierisë dhe Fizioterapisë me rreth 845 kopje. Risi është mundësimi i bibliotekës online: "Cambridge Journals"</p> <p>www.cambridge.org/core; "Questia"</p> <p>www.questia.com; "Elsevier"</p> <p>www.textbooks.elsevier.com, të cilat janë të aksesueshme nën kujdesin e punonjësës së bibliotekës, në qendrën e internetit. Libraritë on</p>
--	--

line të këshilluara janë me drejtim mjekësor.

Biblioteka e Fakultetit është e hapur dhe e shfrytëzueshme çdo ditë të javës nga e hëna në të shtunën me orar të shpallur në ambjentet e fakultetit.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Në funksion të programit të studimit Master Profesional “Infermieri Kirurgjikale” Institucioni disponon laboratore praktike të Infermierisë si dhe laboratore me aparatura, që janë të përshtatshme për mësimdhënie dhe praktike në përputhje me qëllimin e programit.

Ky program ofron mundësi për të punuar në labororet e Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë. Laboratorët qëndrojnë të hapur dhe nën vëmendjen e një mentori/ laboranti studenti mund të bëjë edhe punë të pavarur.

Ne vizituar laboratorët e Anatomisë, Fiziologjisë, Histologjisë, Infermierisë 1 dhe II si edhe sallën e praktikave të Fizioterapisë.

Laboratorët e Praktikës së Infermierisë janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike dhe praktikë. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë çdo fillim viti akademik bën kërkesë për pasurimin e laboratorëve dhe Sallës së praktikës, me mjete shtesë për zhvillimin optimal të procesit mësimor.

Puna me manekinët, infuzionet, manipulimet e tjera konsiderohet plotësisht e realizueshme në këto mjedise.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Mjediset aktuale janë të përshtatshme dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standartet dhe kriteret e cilësisë. Godina disponon një infrastrukturë moderne. Sallat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektor. Laboratorët e Praktikës së Infermierisë janë të pajisura me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e

orëve laboratorike dhe praktike.

2. Biblioteka përgjithësisht ofron kushte të mira, fondi i botimeve ka ardhur duke u pasuruar duke mbuluar në një masë të madhe lëndët me literaturën bazë. Veç kësaj mund të shfrytëzohen edhe bibliotekat on-line si dhe libraritë elektronike, megjithatë *literatura ka nevojë të përditësohet në përputhje me lëndët kurrikulare.*
3. Kryerja e praktikave profesionale realizohet në institucione të tjera shtetërore apo private me të cilat janë lidhur marrëveshje, ku studentët ushtrohen me grupe në pavione dhe qendra shëndetësore.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Albanian University është një Institucion privat i Arsimit të Lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit, të cilat janë kryesisht nga tarifat e shkollimit të studentëve. Në rang universiteti ka një njësi, e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare dhe kontrollin e tyre.

Burimet e brendshme të financimit shpenzohen për qiranë e objektit, mirëmbajtje, pastrim, ngrohje, pagesat dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, shpenzime të lidhura me shërbimin në internet, aparaturat, reklamën, detyrimet ndaj shtetit, etj.

Kostot operative vjetore ndryshojnë nga njëri program studimi tek tjetri, për shkak të veçorive që ka secili prej tyre. Institucioni harton një raport financiar për çdo vit buxhetor nga ekspertë të jashtëm të certifikuar, në të cilin ka të dhëna të hollësishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative, etj. Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje) sipas RVB:

• Pushteti Qëndror	-
• Pushteti Vendor	-
• Fonde Jopublike	-
• Grantet për kërkim dhe kontratat	-
• Konsulencat shërbimet	-
• Tarifat për dhe gjatë shkollimit	282.720.00
• Sponsorizimet	-
• Shërbime trajnuese	-
• Donacionet aktivitetet siguruese	-
• Shuma	282.720.00

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik

Shpenzimet lidhen me fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honorarë në mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, fondi i ekselencës dhe kosto të tjera të departamentit. Kostoja për një student në programin e studimit në “Infermieri Kirurgjikale” është 162688 lekë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>IAL-ja kryen audit të përvitshëm për situatën financiare nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar. Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar billancit për të ardhurat dhe shpenzimet e programeve të studimit.</p> <p>Në 6 vjeçarin e fundit, IAL-ja nuk ka përfitur nga asnjë grant i huaj apo kontrata shërbimesh. Programi i studimit financohet 100% nga tarifatat e shkollimit. Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në ciklet pasardhëse.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni ka një stabilitet financiar, si rezultat i menaxhimit të mirë të të ardhurave dhe ka kapacitet financiar të mjaftueshëm për përmirësim të mëtejshëm të situatës financiare dhe shtim të të ardhurave në të ardhmen, e lidhur kjo dhe me një rekrutim të mirë dhe të justifikuar të studentëve.</p> <p>Institucioni nëpërmjet një bilanci të kujdesshëm deklaron në mënyrë të hollësishme kostot financiare, ku raportet e detajuara në zëra të buxhetit, për çdo vit disponohen nga zyra e financave të Universitetit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Albanian University është një Institucion i Arsimit të Lartë që financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit, të cilat janë kryesisht nga tarifatat e shkollimit të studentëve. 2. Institucioni bën një auditim të përvitshëm të brendshëm dhe të jashtëm të situatës financiare të tij, ku raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave të tarifave studentore në 	

funksion të programit të studimit.

3. Institucioni menaxhon mirë të ardhurat dhe ka një stabilitet financiar dhe të mjaftueshëm për një përmirësim të mëtejshëm të situatës financiare.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë është institucionalizuar me vendim Senatit Akademik Nr. 178 dt. 23/07/2010, dhe me vendimin Nr. 157/3 dt. 08/09/2016, e cila realizon vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë së aktivitetit akademik, siguron drejtimin, këshillimin dhe mbështetjen për hartimin dhe zbatimin e procedurave të brendshme të sigurimit të cilësisë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 80/2015, aktet nënligjore, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit.

Me vendim të Senatit Akademik dt. 22/12/2016, Albanian University ka ngritur dhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësimin Institucional, i cili është përgjegjës për ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Sistemit të Brendshëm të Cilësisë si dhe kontrollin e veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Gjithashtu me Vendim të Senatit Akademik Nr. 157/3 dt. 08/09/2016 u vendos ngritja e grupeve të Sigurimit të Cilësisë, me 2-3 pedagogë të brendshëm të secilit departament, të cilët janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë në nivel departamenti, hartojnë raporte të vlerësimit të brendshëm. NJSBC bashkëpunon me njësitë bazë duke analizuar të dhënat e nxjerra në nivel departamenti me synimin e rritjes së performancës së mësimdhënies si dhe të kërkimit shkencor.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila funksionon në Albanian University që prej vitit 2010 e zhvillon veprimtarinë e saj në kuadër të Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Bazuar në dokumentacionin e dhënë dhe kontakteve që patëm gjatë vizitës në Institucion, NJSBC realizon 2 herë në vit pyetësorët me studentët, në përfundim të semestrit të parë dhe në fund të vitit, përpara sezonit të provimeve.

Studentët e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, kanë zhvilluar një pyetësor në përfundim të semestrit të parë për vitin akademik 2018-2019, ku këtë vit pyetësori për studentët është realizuar online. Të dhënat e marra nga pyetësorët janë përpunuar dhe në lidhje me rezultatet dhe problematikat e tyre, stafi i pedagogëve është informuar në mënyrë konfidenciale. Nuk janë vërejtur problematika në lidhje me stafin akademik dhe atë administrativ, vlerësimet në programin e studimit janë pozitive. Studentët ngrenë shqetësimet e tyre në lidhje me sistemin e rreptë të mungesave në leksione dhe seminare si dhe orarin e zgjatur të leksioneve. Në lidhje me shqetësimet e ngritura të

studentëve departamenti ka marrë masat që javën e 15- të kalendarit akademik t'u krijojë mundësi për shlyerjen e mungesave, si dhe të përmirësojë çështjet e ngritura prej tyre në lidhje me oraret e leksioneve gjatë semestrit të dytë.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Albanian University është përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse të saj. Për këtë, pranë AU funksionon Struktura e Cilësisë ku pjesë përbërëse të së cilës janë: Komisioni për Vlerësimin Institucional dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Komisioni për vlerësimin Institucional kontrollon veprimtarinë e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë mbi bazën e një raporti periodik 6 mujor që hartohet prej saj. ZSBC planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë: të programeve të studimit dhe vlerësimin të brendshëm të institucionit. Kontrolli i brendshëm i cilësisë së programeve të studimit realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik dhe veçanërisht në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik.

Sipas të dhënave të marra nga Institucioni, vlerësimi bazohet në të dhënat e marra gjatë sondazheve, pyetësorët që u bëhen studentëve, raportet e vetëvlerësimit të pedagogëve (në të cilat paraqitet puna e pedagogëve përmes raportit të vetëvlerësimit, pra sa përqind janë realizuar objektivat mësimore nga ana e tyre), takimeve me fokus-grupet etj, të dhëna, të cilat dorëzohen në departament dhe përfshihen në raportin semestral dhe atë vjetor duke nxjerrë problematikat e shfaqura dhe rekomandimet për të përmirësuar punën në vazhdimësi.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Ngritja e grupeve ad-hoc, të cilat përbëhen nga 2 ose 3 pedagogë të brendshëm, me tituj dhe grada, në nivel departamenti që bashkëpunojnë me NJSBC realizon rishikimin e syllabuseve dhe kurrikulave para çdo viti akademik, hartojnë raporte të vlerësimit të brendshëm, të cilat i shërbejnë nxitjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Nga dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitës në Institucion, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përbëhet nga 3 pedagogë, të cilët merren me sigurimin e cilësisë në nivel departamenti.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka ngritur grupin hartues të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, 1 kryetar dhe 4 anëtarë, njëri prej të cilëve është student. Ky grup hartoi një raport, i cili paraqet një analizë të hollësishme të veprimtarisë së Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në kuadrin e dispozitave të reja ligjore për riorganizimin e programit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”. Gjithashtu paraqet dhe analizën mbi vlerësimin e brendshëm të cilësisë së procesit mësimor në realizimin e këtij programi studimi, aktivitetin shkencor të realizuar nga stafi akademik, lidhjet e qëndrueshme dhe afatgjata me partnerët e institucioneve shëndetësore brenda vendit për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, arritjet e studentëve, duke paraqitur njëkohësisht edhe pikat e dobëta, të lidhura sidomos me numrin e ulët të projekteve kërkimore shkencore të mirëfillta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar/njësi bazë apo numrin e ulët të pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit dhe pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit (analiza SWOT).

Vetëvlerësimet periodike identifikojnë arritjet dhe problemet e ngritura, të cilat i komunikohen stafit për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre.



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; 	<p>Institucioni, për akreditimin dhe ecurinë e programeve të studimit përdor metoda matëse dhe vlerësuese, të cilat synojnë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, përmirësimin e procesit të mësimdhënies, të syllabuseve, të performancës së stafit akademik, si dhe në gjetjen e metodave efikase për vlerësimin e studentëve.</p> <p>Raporti semestral dhe vjetor për Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë, i përfshirë në dokumentacionin e marrë gjatë vizitës në Institucion paraqet në mënyrë të detajuar punën e bërë për ecurinë e duhur të programeve të studimit.</p> <p>Në informacionin e dhënë mbi programin e studimit Master profesional në “Infermieri Kirurgjikale” përshkruhet në mënyrë të hollësishme realizimi i orëve mësimore nga pedagogët për secilën lëndë të përfshirë në kurrikul dhe arsyet në rastet e mosrealizimit të tyre sipas kurrikulës, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare e rezultateve të studimit.</p> <p>Institucioni nëpërmjet NJSBC përdor metoda të tërthorta vlerësimi, si:</p> <ol style="list-style-type: none"> Pyetësorët e studentëve, të kryera 2 herë në vit, ku përfshihen vlerësime për pedagogun, lëndën, për stafin administrativ dhe Universitetin. Raportin e vetëvlerësimit të pedagogut për të treguar se sa janë realizuar prej tij qëllimi dhe objektivat e synuara në lëndën përkatëse. Vlerësimi i punës së pedagogëve e matur nga drejtuesi i departamentit. Bazuar në propozimet e NJSBC, Institucioni përdor dhe një pyetësor drejtuar personelit akademik i fokusuar në infrastrukturën, mbështetjen e institucionit, kënaqësinë në punë, etj. Krijimi i fokus - grupeve të përbërë nga 8-10

<p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>studentë, të cilët janë intervistuar për të dëgjuar shqetësimet e tyre në lidhje me procesin e mësimdhënies, marrëdhëniet me stafin akademik dhe administrativ, etj.</p> <p>Metodat e drejtpërdrejta lidhen me :</p> <p>a. Vlerësimin me nota dhe pikë të studentëve, të përshkruara në syllabusin e lëndës.</p> <p>b. Vlerësimin e studentëve nëpërmjet testeve paraprake dhe përfundimtare, praktikave profesionale, realizimit të detyrave gjatë realizimit të programit të studimit, etj.</p>
---	--

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

Bazuar në RVB, Institucioni harton raportin mbi analizën e programeve të studimit, të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore, si pjesë e vlerësimit të brendshëm në përfundim të çdo viti akademik.

Raporti miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të Institucionit, publikohet në faqen web dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/15 dërgohet në MASR.

(<https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/>)

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore harton raportin semestral dhe vjetor të analizës së punës së Departamentit. Nga shqyrtimi i analizës vjetore, vihet re një përshkrim i hollësishëm i punës së departamentit në realizimin e programeve të studimit.

Vlerësimi i ecurisë është i fokusuar në rishikimin e kurrikulave të programeve të studimit, rishikimi dhe miratimi i Rregulloreve për çdo program studimi sipas Ligjit të Arsimit të Lartë, rekrutimi i stafit akademik, vlerësimi i punës së pedagogut, mësimdhënia dhe studentët, kërkimi shkencor, financimi i veprimtarisë shkencore dhe kualifikimet e stafit dhe financimi i veprimtarisë së studentëve.

Institucioni harton politika për përmirësimin e

	<p>programeve të studimit, ku nëpërmjet analizës SWOT të përfshirë në raportin vjetor dalin në pah pikat e forta dhe të dobta të departamentit si dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedurën të caktuar për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University” është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.197, datë 10.04.2004, ku përgjatë viteve ky IAL ka pësuar një sërë ndryshimesh si në emërtim dhe në strukturën e tij.</p> <p>Me Urdhër të MAS Nr. 596, datë 21.12.2016 Miratohet Statuti & Organigrama e re në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015.</p> <p>AU ka kryer procedurat e akreditimit institucional dhe bazuar në Vendim e Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017 institucioni është akredituar për një kohëzgjatje 2 vjeçare (Vendim i Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017).</p> <p>Institucioni impenjohet në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe konsolidimit të programeve të studimit, ku strategjia, politika dhe procedurat që ndjek janë paraqitur në mënyrë të detajuar në dokumentacionin e dhënë nga Institucioni.</p> <p>Ngritja e strukturave për sigurimin e cilësisë deri në nivel departamenti duke përdorur instrumentat e duhura, hartimi i raporteve vlerësuese semestrale dhe vjetore për të ilustruar aktivitetin e kryer në përmbushjen e qëllimit dhe misionit të programit të studimit, hartimi i pyetësorëve për stafin akademik dhe studentët, rishikimi i vazhdueshëm i syllabuseve, përditësimi i literaturës etj., janë tregues së politikës së ndjekur nga Institucioni.</p> <p>Gjithashtu konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i zyrave qëndrore administrative si p.sh, Zyra e Karrierës dhe Alumnit që mban lidhje me tregun e punës, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Zyra e Projekteve që ndihmon stafin në përthithjen e projekteve kërkimore, etj, përfshihen në planin strategjik të zhvillimit të Institucionit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	



1. Në AU sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe funksionon me të gjitha strukturat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë NJSBC përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta vlerësimi për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.
2. Ngritja e strukturave për sigurimin e cilësisë edhe në nivel departamenti që bashkëpunojnë me NJSBC është pjesë e planit strategjik të Institucionit për të përmbushur misionin e tij.
3. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përpilon raportet semestrale dhe vjetore që analizojnë në mënyrë të hollësishme punën e departamentit në realizimin e duhur të programit të studimit. Nëpërmjet analizës SWOT të përfshirë në raportin vjetor dalin në pah pikat e forta dhe të dobta të departamentit si dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm.
4. Vetëvlerësimet periodike identifikojnë arritjet dhe problemet e ngritura, të cilat i komunikohen stafit për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” synon të japë kontributin e tij në rritjen e cilësisë profesionale të të diplomuarve në nivelin bachelor Infermieri, të cilët dëshirojnë të vazhdojnë më tej karrierën profesionale duke u specializuar në fushën e Infermierisë kirurgjikale.

Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij në fushën e infermierisë kirurgjikale dhe mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara, për arsye të karakterit të mirëfilltë profesional të tij. Ai ofrohet në module të veçanta dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 2 semestra dhe me një numër në total 60 Kredite viti. Programi i lëndëve në semestrin e parë të studimit është përpiluar që të mundësojë pajisjen e studentëve me njohuri më të thelluara në nivelin teorik dhe praktik në lëndë të shkencave infermieristike që lidhen me specialitetin e kirurgjisë si: Infermieristika në kirurgjinë infantile, Infermieristika në sallën operatore, Infermieristika në kirurgjinë obstetrikë-gjinekologjike, Infermieristika në kirurgjinë abdominale urologjike, etj. Në semestrin e dytë studenti do të marrë njohuri në lëndë ndrdisiplinore Integruese siç janë: Psikologji e përgjithshme, Sociologji, Etikë Mjekësore. Gjatë të dy semestrave është planifikuar një sasi orësh mësimi praktik në mënyrë që studentët të ushtrojnë praktikë profesionale, e cila do të plotësojë formimin profesional të infermierit të specializuar në kirurgji.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit

Programi i studimit Master i Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është licensuar me Urdhër Nr.479., datë 10.10.2012. Ky Master ka qënë i organizuar në 90 ECTS, me një kohëzgjatje prej 1,5 vite akademike. Masteri Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” që prej fillimit të tij i është nënshtruar proceseve të akreditimit.

Në vitin akademik 2015-2016 u akreditua me kusht në bazë të Urdhërit Nr.242, datë 09.05.2016.

Pas plotësimit të kushteve të parashtruara nga grupi i vlerësimit të jashtëm, në vitin akademik 2016-2017, Programi i Studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” u akreditua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.32, datë 19.05.2017, vetëm për studentët e regjistruar deri në vitin akademik 2016-2017, me kusht që të mos pranohen studentë të rinj deri në riorganizimin e këtij masteri. Ky vendim u shfuqizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.32/2, datë 02.02.2018, në të cilin specifikohet akreditimi dhe për brezin 2017-2018 deri në diplomimin e tyre.

Në kuadër të dispozitave të reja ligjore, përkatësisht Udhëzimi Nr.31, datë 29.12.2017 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë propozoi ngritjen e grupit të punës, për riorganizimin e Master Profesional “Infermieri Kirurgjikale” në përputhje me dispozitat e reja ligjore. Programi i studimit Master i Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” i riorganizuar në 60 ECTS është hapur me miratim të Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, me Vendim të Senatit Akademik dhe miratuar nga MASR me shkresë Nr. 6313/2 datë 18/07/2018.

Programi parashtron në mënyrë të qartë objektivat e përgjithshme dhe specifike të tij. Ky program mbështetet në përvojën disa vjeçare dhe praktikat e mira të vendeve evropiane, në përputhje me misionin, qëllimet e Institucionit dhe strategjinë për zhvillim të Institucionit. Ai është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, me zhvillimin ekonomik të vendit, ofrohet në përputhje me objektivat kombëtarë, ndërkombëtarë dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare.

Në këtë program kanë mundësi të studiojnë infermierë, të cilët kanë kryer arsim tre vjeçar (cikli i parë Bachelor) në degën e Infermierisë së Përgjithshme dhe kërkojnë të thellojnë me tej njohuritë e tyre në një specialitet më të ngushtë të shkencave infermieristike, në Infermieristikën Kirurgjikale.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj)

Organizimi i programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është pasqyruar në Kalendarin Akademik të vitit 2018-2019, i cili është organizuar në 2 semestra:

- 1 vit akademik ka **30** javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka **15** javë mësimore në auditor

Emërtimi i Diplomës për programin e studimit, Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”

Në përfundim të programit të plotë të studimeve të Master Profesional, ku studenti ka shlyer të gjitha detyrimet, studenti fiton diplomë në Programin e Studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”. Procesi i diplomimit realizohet me anë të Provimit të Diplomës, ose punimit të një Teme Diplome.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Kreditet për çdo lëndë përcaktojnë ngarkesën në orë mësimore në auditor si dhe punën individuale të studentit për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga syllabusi i lëndëve, ku lëndët dhe modulet vlerësohen nga kreditet. Aktiviteti i formimit përbëhet në kompleks nga 1500 orë që u korrespondojnë 60 kredite, prej të cilave 645 orë mësimore zhvillohen në auditor dhe 855 orët e tjera janë orë studimi individual. 1 kredit përfaqëson 25 orë pune mësimore.

Sipas Rregullores së Programit të studimit Master profesional në “Infermieri Kirurgjikale” 1 kredit konvertohet në orë mësimore si më poshtë:

- Leksionet 7.5 orë mësimore
- Seminaret 7.5 orë mësimore
- Laborator 22.5 orë mësimore
- Det/Proj 2 orë mësimore
- Praktikë 25 orë mësimore

Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, laboratorët, projektet, detyrat e kursit, etj, të organizuara në 17 module, ku janë parashikuar 14 provime duke e përfshirë provimin e diplomës/ temë diplome.

Tabela e planit mësimor për vitin akademik 2018-2019 është paraqitur në aneks.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- | | | |
|--------------------------|-------------------------------|---|
| ▪ Leksionet | 180 orë në auditor dhe | 420 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Seminaret | 45 orë në auditor dhe | 105 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Praktikët lëndore | 270 orë në auditor dhe | 30 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Praktikën Profesionale | 150 orë në auditor dhe | 0 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Provimi përfundimtar | 0 orë në auditor dhe | 250 orë punë e pavarur e studentit |

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Studenti, i cili ndjek këtë program studimi duhet të plotësojë 60 ECTS, të cilat në Programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” janë organizuar në 5 kategori sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Secila kategori përfaqëson disiplinat përkatëse të organizuara në kredite të përcaktuara qartë: 6 ECTS janë Lëndët Bazë (A), 24 ECTS Lëndët Karakterizuese për disiplinat shkencore (B), 6 ECTS Lëndët me Zgjedhje (C), 6 ECTS Lëndët Plotësuese (D), 10 ECTS Detyrimet Përmbyllëse (E), ku përfshihen Provimi përfundimtar/ Tema diplome. Plani mësimor i programit të studimit Master profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është organizuar bazuar në këto udhëzime.

Në dokumentacionin që na u dha gjatë vizitës në institucion në lidhje me analizën e ndryshimeve mbi riorganizimin e Master Profesional “Infermieri Kirurgjikale” nga 90 ECTS në 60 ECTS vihet re:

1. Në kurrikul janë shtuar 2 lëndë të reja: 1. “Statistikë dhe Promocion Shëndetësor” (si pjesë e formimit të përgjithshëm të studentit), 2. “Anestezi - Reanimacion dhe Kujdesi Infermieror” (si lëndë e një rëndësie të veçantë në formimin dhe profilizimin e studentit në këtë program studimi).
2. Lënda Anglisht e pranishme në programin e studimit me 90 ETCS është hequr me riorganizimin e programit, meqë studentët i kanë marrë njohuritë e mjaftueshme në programin e studimit Bachelor në Infermieri.
3. Lënda “Etikë Mjekësore” është futur si lëndë me zgjedhje.
4. Gjithashtu dhe lëndët “Psikologji Mjekësore” dhe “Sociologji Mjekësore”, të cilat ishin lëndë të detyrueshme janë bërë si lëndë me zgjedhje duke i riorganizuar kreditet (ishin 4 ETCS bëhen 3 ETCS).
5. Ndërkohë që është menduar që të gjitha lëndët e tjera të mbeten, por duke u riorganizuar në raportin e orëve leksion/seminare/praktikë laboratorike duke rritur orët e praktikës në laborator.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit mbi Planin mësimor lidhur me personelin akademik përkatës, të vitit 2018-2019 janë pasqyruar emrat e pedagogëve dhe lëndët/modulet përkatëse që ata zhvillojnë në programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, titulli/grada e personelit akademik, statusi PAE/PAK dhe ngarkesa në orë për secilën lëndë/modul.

Referuar këtij dokumenti shihet që pjesa më e madhe e lëndëve mbulohet nga PAE, 1087.5 orë të realizuara nga PAE dhe 412.5 orë të realizuara nga PAK. Pra **PAE mbulon 73%** të orëve të këtij programi mësimor.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Nga vlerësimi i syllabuseve për programin e studimit Master Profesional “Infermieri Kirurgjikale” për çdo lëndë, u evidentua një paraqitje në mënyrë të detajuar e elementëve të përmbajtjes, sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, Shtojca nr. 1, “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Elementet renditen sipas një kronologjie të caktuar, duke filluar me titullin e modulit, vitin akademik, semestrin kur zhvillohet lënda, kreditet dhe orët në auditor dhe jashtë auditorit, emrin e pedagogut përgjegjës për të, përshkrimin e shkurtër të lëndëve me një informacion të përgjithshëm rreth saj, objektivat e lëndës dhe çfarë pritet që studenti të përfitojë në fund të saj, temat e trajtuara, format e mësimdhënies në leksione, seminare, ushtrime, praktika profesionale dhe raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën dhe së fundi literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar.

Megjithatë Syllabuset kanë nevojë për një rishikim të tyre nga ana e pedagogëve bazuar në vërejtjet dhe sugjerimet e mëposhtme:

1. Rishikimi i emërimit të lëndëve/moduleve në përputhje me profilin e pedagogut përgjegjës si dhe me literaturën e detyruar dhe të rekomanduar që është përshkruar nga lektorët.
2. Ka syllabuse që në literaturën e përdorur, sidomos atë të rekomanduar mungon viti i botimit të tyre, ose në mjaft prej syllabuseve, literatura (kryesisht ajo e rekomanduar) është e vjetër.
3. Tek plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës të këtij programi mungon moduli me zgjedhje: “Etikë mjekësore”. Syllabusi i këtij moduli gjendet në morinë e syllabuseve të dorëzuara nga pedagogët, tek i cili tërheqim vëmendjen në lidhje me tematikat e përshkruara në syllabus, një pjesë e të cilave janë njohuri bazë që studenti i merr gjatë ciklit të parë të studimeve. Tematika

duhet të jetë më gjerësisht informuese dhe selektive për studentët që ndjekin ciklin e dytë të studimeve në këtë program studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” organizohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore nën përgjegjësinë e Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë.</p> <p>Programi i studimit Master i Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është licensuar me Urdhër Nr.479., datë 10.10.2012. Në vitin akademik 2015-2016 u akreditua me kusht në bazë të Urdhërit Nr.242, datë 09.05.2016. Pas plotësimit të kushteve të parashtruara nga grupi i vlerësimit të jashtëm, në vitin akademik 2016-2017, Programi i Studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” u akreditua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.32, datë 19.05.2017, vetëm për studentët e regjistruar deri në vitin akademik 2016-2017, me kusht që të mos pranohen studentë të rinj deri në riorganizimin e këtij masteri. Ky vendim u shfuqizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.32/2, datë 02.02.2018, në të cilin specifikohet akreditimi dhe për brezin 2017-2018 deri në diplomimin e tyre. Me Vendim të Senatit Akademik dhe miratuar nga MASR me shkresë Nr. 6313/2 datë 18/07/2018, programi u riorganizua me 60 kredite.</p> <p>Ky program ofrohet në module të veçanta dhe është i vlerësuar me kredite, sipas sistemit evropian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS).</p> <p>Kurrikula e këtij programi ka një kohëzgjatje të rregullt, të planifikuar në 2 semestra me një numër total 60 kredite.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, që përfshijnë dijet, kompetencat dhe aftësitë profesionale duke</p>

<p>zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>mundësuar aplikimin në praktikë të njohurive të marra dhe duke synuar në kualifikimin e mëtejshëm të studentëve për punësim.</p> <p>Bazuar në planin mësimor të këtij programi studimi vihet re që gjatë semestrit të parë synohet që studentët të pajisen me njohuri më të thelluara në planin teorik dhe praktik të shkencave Infermieristike në fushën kirurgjikale, ndërsa gjatë semestrit të dytë, studentët marrin njohuri në lëndë ndërdisiplinore integruese.</p> <p>Janë planifikuar dhe orët praktike që synojnë formimin profesional të infermierëve të specializuar në kirurgji.</p> <p>Ky program duke ofruar disiplina të karakterit profilizues profesional shmang përsëritjen e njohurive formuese të ofruara gjatë ciklit të parë të studimit Bachelor.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit parashtron objektiva të përgjithshme dhe specifike, të cilat paraqesin në vetvete misionin që dëshiron të përmbushë ky program, duke iu përshtatur mjaft mirë nivelit të studimit që ai kërkon.</p> <p>Në kontaktet që patëm gjatë vizitës në Institucion me studentë dhe pedagogë morëm informacione mbi metodatat e vlerësimit të studentëve, ku dija e studentit kontrollohet nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme</p>

	pedagog – student në formën e bashkëbisedimeve dhe mbështetet në provimet e ndërmjetme të moduleve, frekuentimin, pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, laboratore, praktika, detyra kursi.
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislativën dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” përmban elementë të detajuar (të pasqyruar në dokumentacionin e marrë në Institucion), të cilat paraqesin aspektet organizative të këtij programi duke u bazuar në modelin e Bolonjës, aktet ligjore dhe nënligjore për arsimin e lartë në fuqi dhe programe studimi të ngjashme me Universitetet italiane.</p> <p>Ky program është hartuar në përputhje me misionin dhe strategjinë për zhvillim të Institucionit duke u bazuar dhe në studime mbi nevojat e tregut shqiptar dhe zhvillimin ekonomik të vendit.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” synon në formimin e profesionistëve të aftë dhe të kualifikuar për tregun e punës.</p> <p>Kryerja e praktikave mësimore në laboratorët e Infermierisë dhe praktikave profesionale jashtë auditorit, në spitalet private dhe shtetërore, me të cilat AU ka marrëveshje intitucionale duke ndërthurrur elemente teorike dhe praktike i shërbejnë qëllimit të këtij programi.</p> <p>Personeli akademik është i angazhuar në punën kërkimore shkencore në funksion të këtij programi studimi. Konferencat, leksionet e hapura të organizuara në rang departamenti trajtojnë tematika në përputhje me nivelin e këtij programi studimi dhe u përshtaten syllabuseve të tij. Por nga ana tjetër i aftësojnë studentët në përgatitjen e prezantimeve akademike dhe përgatitjen e temave të diplomës.</p>
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, ky program ofrohet në përputhje me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare, me zhvillimin ekonomik të vendit duke synuar punësim të Diplomuarve në tregun shqiptar dhe të huaj.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, gjatë vitit akademik 2017-2018, ka ndërmarrë një studim të tregut të punës në hapjen e programeve të reja në përputhje me mundësitë e punësimit të ofruara në nivel kombëtar e ndërkombëtar, kryesisht për Fizioterapinë në fushën e Terapisë Manuale.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Duke shqyrtuar me vëmendje dokumentacionin e këtij programi studimi, kurrikulën, objektivat e përgjithshëm dhe specifik të tij të shprehura qartësisht në rregulloren e programit, ato synojnë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ka një kohëzgjatje normale 1 vjeçare duke u zhvilluar në 2 semestra, të cilave u përkojnë 60 kredite.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të</p>	<p>N/A</p>

studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Programet e studimeve të ciklit të dytë janë të detajuara dhe informuese. Institucioni ka një strukturë të informimit dhe këshillimit për studentët.</p> <p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, modulet, tematikën e syllabuseve, format e vlerësimit të lëndës, format e mësimdhënies, detyrimet e studentëve në lidhje me frekuentimin e lëndës, informacione të cilat vihen në dispozicion të studentëve në formë elektronike dhe hardcopy.</p> <p>Kjo u evidentua dhe në takimet që patëm gjatë vizitës në Institucion me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”.</p>
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Procedurat e diplomimit të studentit parashikohen në programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ku përcaktohen kërkesat e diplomimit, komisioni i diplomës, procedurat e mbrojtjes së diplomës.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është vlerësuar me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), kurrikula e të cilit ka një kohëzgjatje të planifikuar në 2 semestra me një numër total 60 kredite. 2. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë, të përgjithshme dhe specifike që i përshtaten nivelit të studimit që ai kërkon. Ofron disiplina të karakterit profilizues profesional dhe synon në formimin e profesionistëve të aftë dhe të kualifikuar për tregun e punës. Konferencat, leksionet e hapura të organizuara në rang departamenti trajtojnë tematika në përputhje me nivelin e këtij programi studimi dhe i aftësojnë studentët në përgatitjen e prezantimeve akademike dhe përgatitjen e temave të diplomës. 3. Plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve janë organizuar me elementet e duhura bazuar në VKM 	

4. *GVJ rekomandon të rishikohen syllabuset, kryesisht përsa i përket përzgjedhjes së literaturës së rekomanduar dhe rishikimin e emërimit të lëndëve/moduleve nga ana e pedagogëve.*

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Universiteti Privat "Albanian University" është një institucion, me objektiva të përcaktuara qartë që synojnë në perfeksionimin e metodologjisë së mësimdhënies, përshtatjen dhe zbatimin e praktikave akademike më të përparuara që synojnë ndërthurjen e teorisë me praktikën duke u ofruar studentëve mënyrën më të mirë të edukimit dhe duke i aftësuar në tregun ndërkombëtar të punës.

Veprimtaria mësimore zhvillohet nëpërmjet leksioneve në auditor, seminareve, laboreve, praktikave, detyrave të kursit, projekteve. Leksionet në auditor zhvillohen jo më shumë se 25 orë në javë. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 min. Puna mësimore organizohet në bazë grupi, kursi dhe nëngrupi. Leksionet zhvillohen në bazë kursi, ndërsa ushtrimet, seminarët, praktikat zhvillohen në bazë grupi mësimor duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore. Sipas informacioneve që morëm gjatë vizitës në Institucion, leksionet realizohen në power point përmes slideve të materialeve të përgatitura. Bëhen demonstrime me video, imazhe, foto nga aktivitetet praktike në sallën dhe bllokun operator, asistencë postoperative në repart, etj. Orët e laboratorit zhvillohen në laboreve të Infermierisë dhe metodat që përdoren janë simulime, demonstrime instrumentash kirurgjikale, shembuj përdorimi instrumentash me manekinë, injektim medikamentesh në manekin, etj. Në seminarët bëhen diskutime, kontroll i dijeve nëpërmjet pyetjeve të drejtpërdrejta, diskutime rastesh studimi, punë individuale në grup, etj.

Frekuentimi i leksioneve dhe seminareve në të paktën 75% të seancave është i detyrueshëm për t'i lejuar studentëve që të futen në lëndën përkatëse. Frekuentimi në punët laboratorike dhe praktikat profesionale është 100% i detyrueshëm. Numri total i provimeve është 14, ku janë parashikuar 13 provime dhe 1 provim përfundimtar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Format e kontrollit të njohurive

Nisur nga bisedat me studentë dhe pedagogë gjatë vizitës 2 ditore në Institucion, si dhe nga dokumentacioni i marrë, format e kontrollit të dijeve përfshijnë:

- | | |
|--|-----|
| • pjesëmarrje dhe aktivizim në orët e seminareve | 10% |
| • dorëzim i detyrave të kursit | 0% |

- vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë 10%
- provim i ndërmjetëm 20%
- provim përfundimtar 60%
- Gjithsej 100%

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët aktivizohen në aktivitete shkencore në rang departamenti. Kështu Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë gjatë këtyre 2 viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 ka zhvilluar dhe 2 Konferenca Studentore, për të cilat disponojmë dhe dokumentacionin përkatës. Konferenca studentore në 16 mars 2018, ku morën pjesë 21 studentë aktivë dhe Konferenca studentore në 18 Mars 2019, ku morën pjesë 22 studentë aktivë.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Albanian University ka përcaktuar Rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve, e cila bazohet në Ligjin nr. 80, datë 22.05.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të AU. Pranimi në programet e ciklit të dytë është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të AU. Këto kriteret përcaktohen nga njësi bazë ofruese e programit.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Në Rregulloren e programit të studimit Master Profesional “Infermieri Kirurgjikale” përcaktohen kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve në këtë program. Këto kriteret përfshijnë:

Çdo kandidat është i detyruar të plotësojë këto kriteret:

1. Të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve Bachelor në përputhje me fushën e studimit ku ka grumbulluar 180 kredite ECTS.
2. Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga Institucioni.
3. Të paguajë tarifën e caktuar vjetore.

Në rast se studenti ka përfunduar një diplomë tjetër jashtë disiplinës së përcaktuar më lart atëherë Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimeve të programeve i ngritur nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore vlerëson aplikimin duke u bazuar në Rregulloren Regjistrimeve dhe Transferimeve.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Bazuar ne RVB për vitin akademik 2018-2019 nota mesatare hyrëse ka qenë 6.9.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Gjatë vitit akademik 2017-2018, në programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, 90 ECTS janë regjistruar në vitin e parë 157 studentë, me notë mesatare 6.84.

Gjatë vitit akademik 2018-2019, në programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” 60 ECTS janë regjistruar për herë të parë 152 studentë me notë mesatare 6.9.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit

Në total për vitet 2018 -2019 janë diplomuar 315 studentë.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve, Albanian University mundëson transferimin e studentëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të dytë, midis programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private ose publike, vendase ose të huaja si dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera të arsimit të lartë.

Sipas të dhënave të marra gjatë vizitës në Institucion gjatë vitit akademik 2018 – 2019 në programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” nuk ka studentë të larguar dhe as të transferuar.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Në total, përgjatë periudhës 2018-2019 janë diplomuar 315 studentë dhe punësuar të gjithë, prej të cilëve 94 janë punësuar në përputhje me diplomën dhe 221 janë të punësuar jo në përputhje me diplomën.

Numri total të diplomuarve

315 studentë të diplomuar

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

94 studentë

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

221 studentë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, të përfshirë në dokumentacionin e marrë në Institucion janë paraqitur kriteret, të cilat duhet të plotësojë aplikanti për t’u pranuar në këtë program studimi.</p> <p>Studenti duhet të ketë përfituar një diplomë të ciklit të parë Bachelor, në përputhje me fushën e studimit.</p> <p>Studentët e regjistruar në këtë program studimi plotësojnë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë, diplomë të ciklit të parë, dosjen e studentit dhe pagesën vjetore të tarifës së studimit. Nuk ka kriteret specifike për pranimin e studenteve në këtë program studimi. Dokumentat e aplikimit që përbëjnë dosjen e pranimit janë formulari i aplikimit, letër interesi për programin e studimit, kopjen e noterizuar e Diplomës së Nivelit të Parë ose një diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit ekuivalente, lista e notave e noterizuar, CV-ja e kandidatit ku paraqiten të dhëna biografike, dokument identifikimi dhe 2 fotografi.</p> <p>Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, studentët e regjistruar në programet e studimit Master Profesional, nuk kanë detyrim ligjor njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian dhe institucioni nuk e ka kusht pranimi njohjen e një gjuhe të huaj.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në takimet që patëm me studentët e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” u informuam mbi mënyrën se si ata marrin informacione të ndryshme mbi programin e studimit që atyre u ofrohet dhe mundësitë për punësim pas diplomimit të tyre në përfundim të këtij programi studimi.</p> <p>Për dhënien e këtyre informacioneve, Institucioni ve në dispozicion të studentëve 2 zyra specifike: “Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve” dhe “Zyra e Karrierës dhe Alumnit”.</p> <p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve ka si objekt kryesor të mbështetë studentët në përgatitjen e tyre më të mirë për punësim dhe të shërbejë në inkurajimin dhe zhvillimin e karrierës së</p>

tyre duke shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës. Kjo zyrë vë në dispozicion të studentëve materiale dhe broshura informuese për t'i orientuar ata për të njohur organizimin e institucionit si dhe të drejtat e tyre nëpërmjet Manualit të Studentit.

Gjithashtu në fillim të vitit akademik Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve në bashkëpunim me Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë dhe Klubet studentore organizon javën orientuese ku studentët njihen me funksionimin e secilës zyrë, liçensimin e programit, akreditimin e tij, kurrikulën mësimore që studentët do të zhvillojnë gjatë ciklit të tyre të studimit, etj.

Zyra e Karrierës dhe Alumnit ofron informacion për studentët e diplomuar (Alumni) mbi ofertat e tregut të punës, mundësitë e praktikave, organizon aktivitete ekstrakurrikulare me qëllim shkëmbimin e eksperiencave të punësimit, etj. Në përfundim të vitit të tretë akademik, studentëve u vihet në dispozicion "Udhëzuesi për Zhvillimin e Karrierës" ku i informon si të planifikojnë karrierën, si të përgatitin një CV, letër motivimi, teknikat e përgatitjes për intervistën e punës, etj.

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.

Institucioni mban të dhëna statistikore mbi numrin e të regjistruarve, të transferuarve dhe të larguarve nga programi i studimit; të dhëna për numrin e të diplomuarve që kanë përfunduar programin e studimit; si dhe të dhëna mbi ecurinë e studimeve të tyre, që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe

programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;

Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.

Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm Zyra e Karrierës dhe Alumnit kujdeset në mënyrë periodike për krijimin e një database statistikash të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve në Albanian University.

Zyra e Karrierës dhe Alumnit organizon takime mes studentëve të diplomuar me studentët aktualë me qëllim shkëmbimin e eksperiencave të punësimit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, bazuar në kalendarin zyrtar të takimeve.

Studentët e diplomuar do të japin informacione në bazë të përvojës së tyre personale, këshillim karriere për studentët që janë aktualisht pjesë e tij dhe mbështetje në formimin e tyre profesional.

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

Gjatë takimit që patëm në Institucion me studentët e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" u informuam mbi vlerësimet e tyre gjatë semestrit, komunikimin me pedagogët mbi rezultatet e vlerësimeve.

Pedagogët informojnë studentët mbi vlerësimet e tyre në lëndën/modulin përkatës, të cilat mund të përfshijnë vlerësimin e provimit të ndërmjetëm, vlerësimet në seminare, laboratore dhe detyra kursi si dhe provimin përfundimtar.

Studenti ka të drejtën e rishikimit të tezës brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve, pasi ka paraqitur një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë mësimore.

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur

Institucioni u ofron këshillim studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes (Tutoriati dhe Mentorimi) mbështet, inkurajon përmes informimit, këshillimit, trajnimit dhe udhëzimit në karrierë.

Në takimet që patëm gjatë vizitës në Institucion dhe dokumentacionin e marrë u njohëm me rregulloren e kësaj zyre, në të cilin pasqyrohen qartë funksionet e

parashikohet një e tillë.	<p>saj. Në bashkëpunim me Dekanin e Fakultetit, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes siguron realizimin e programit të mentorimit për studentët, i cili mundëson njohuri profesionale, obligime ligjore, nëpërmjet takimit me profesionistë të fushës.</p> <p>Gjithashtu përfshin dhe realizimin e mësimit praktik të studentit nën mbikqyrjen e mentorit. Mentori caktohet nga Dekani i Fakultetit dhe mbikqyr studentët gjatë praktikës profesionale, në Institucionin me të cilin AU ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Pas përfundimit të mësimit praktik mentori i studentit, pas kompletimit të të gjitha vërtetimeve të dorëzuara nga studentët dorëzon në Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj studentit një listë të studentëve, të cilët kanë përfunduar praktikën profesionale.</p>
---------------------------	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Studentët e pranuar në programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” kanë një diplomë të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri të përgjithshme” dhe kanë plotësuar kriteret dhe procedurat e pranimit të tyre të përcaktuara në Rregulloren e këtij programi studimi.
2. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit, të cilat Institucioni i ve në dispozicion të studentëve i informojnë ata mbi programin e studimit që u ofrohet, i mbështetin në përgatitjen e tyre më të mirë për punësim, ofrojnë informacione për studentët e diplomuar (Alumni) mbi ofertat e tregut të punës, organizojnë aktivitete ekstrakurrikulare, me qëllim shkëmbimin e ekperiencave të punësimit, etj.
3. “Manuali i Studentit” dhe “Udhëzuesi për Zhvillimin e Karrierës” që Institucioni ve në dispozicion të studentëve, jep një informacion të detajuar dhe mjaft të vlefshëm për ta.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Albanian University synon që kërkimi shkencor të jetë pjesë e integruar e veprimtarisë së tij. Nëpërmjet kërkimit synon të rritë shkallën e kualifikimit të stafit të tij akademik dhe t’u ofrojë studentëve aftësi dhe njohuri shkencore dhe praktike të avancuar nëpërmjet përfshirjes në programet mësimore të metodave dhe teknikave bashkëkohore. Sipas përcaktimit të nenit 42 të Statusit të AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80/15, në fillim të çdo viti akademik, stafi akademik planifikon dhe raporton veprimtarinë shkencore.



Veprimtaritë kërkimore bëhen mbi bazën e planit të zhvillimit strategjik të AU, të programeve dhe projekteve të miratuara nga Senati Akademik. Brenda muajit tetor të çdo viti, njësitë kryesore të AU dorëzojnë pranë Komisionit për Kërkimin Shkencor dhe Botimin një raport për planifikimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore për vitin pasardhës, i cili bën dhe vlerësimin e performancës së tij dhe ia kalon për miratim Senatit. Organizimi i konferencave shkencore, projekteve me karakter kërkimor, botimeve në revista, udhëheqjet e temave të diplomës të studentëve, organizimi i leksioneve të hapura, etj, janë tregues të veprimtarisë shkencore në njësinë bazë. AU publikon 2 herë në vit, që nga viti 2010, revistën periodike "OPTIME" duke stimuluar stafin akademik për të publikuar punime shkencore, të cilat ndikojnë në ngritjen profesionale të tij. Veprimtaria kërkimore shkencore e Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë synon në rritjen e punimeve shkencore nga ana e stafit akademik dhe mbështetjen e veprimtarisë së tyre, integrimin e kërkimit shkencor në mësimdhënie, përfshirjen e studentëve nëpërmjet organizimit të konferencave studentore, të cilat i aftësojnë ata në prezantimin e punimeve të tyre dhe temave të Diplomës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Bazuar në dokumentacionin e dhënë nga Institucioni mbi "Formularin e vlerësimit të kapaciteve njerëzore në fushën akademike e kërkimore shkencore" shihet një pjesëmarrje në 4 projekte individuale: 1 kombëtar dhe 3 ndërkombëtare, të pedagogëve të angazhuar në mësimdhënie në Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë, gjatë periudhës 2015-2019. Nuk ka ndonjë projekt të iniciuar në rang departamenti, por projekte individuale të stafit akademik, që ndihmojnë dhe për punën e tyre me studentët.

Gjithashtu aktiviteti kërkimor shkencor, i konfirmuar edhe nga takimet që patëm gjatë vizitës në Institucion me studentë dhe pedagogë konsiston në organizimin e Konferencave Studentore dhe Konferencave të Departamentit, si dhe zhvillimin e disa leksioneve të hapura:

Për vitin akademik 2017-2018:

1. Konferenca e Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë në bashkëpunim me Departamentin e Stomatologjisë dhe Farmacisë, e organizuar në 29-30 Shtator 2017.
2. Konferenca në nivel Departamenti, në 27-28 Prill 2018 me temë: "Infermieri Klinike, Kirurgjikale dhe Rehabilitim" me një pjesëmarrje të gjerë studentësh, pedagogësh ku pati dhe profesorë italianë të ftuar.
3. Konferenca studentore, në 16 Mars 2018 "Risi shkencore në Rehabilitimin dhe Kujdesin Infermieror"
4. Tryeza e rrumbullakët Klinika Bavaria, në 11 Korrik 2018
5. Janë zhvilluar dhe 2 leksione të hapura:
 - "Urgjenca në bllokimin e rrugëve të frymëmarrjes në pediatri" në 16 Janar 2018
 - "Përgatitja e temës së diplomës për punime të kërkimit shkencor dhe epidemiologjike" në 24 Prill 2018.

Për vitin akademik 2018-2019 :

1. Konferenca e Departamentit në 5-6 Prill 2019 me temë: "Risi Shkencore në rehabilitim dhe në Kujdesin Infermieror"

2. Konferenca studentore në 18 Mars 2019 “Etika dhe shërbimi shëndetësor në këndvështrimin studentor”.
3. Janë zhvilluar dhe 2 leksione të hapura:
 - “Profilaksia e infeksioneve spitalore në pacientët e kateterizuar dhe të hospitalizuar” në 17 Janar 2019.
 - “CARPE DIEM” Si të shkruajmë një artikull shkencor (këshilla rreth shkrimit dhe prezantimit akademik) në 07 Mars 2019.

➤ **Përsa i përket veprimtarive kërkimore – shkencore në funksion të “Edukimit në Vazhdim”:**

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në bashkëpunim me specialistë të fushës ka planifikuar për vitin akademik 2018-2019 me studentët që ndjekin studimet në Masterin Profesional “Infermieri Kirurgjikale” dhe ata të cilët kanë përfunduar studimet në këtë program studimi, aktivitete të nevojshme mbi tematika në funksion të nevojave të profesionit të tyre për informacione shtesë që i shërbejnë përmirësimit të cilësisë. Kalandari i këtyre veprimtarive kërkimore – shkencore në funksion të “Edukimit në Vazhdim” përfshin periudhën tetor 2018 – qershor 2019, ku gjatë këtyre muajve do të zhvillohen 10 tema të ndryshme të lidhura tërësisht me këtë program studimi, të cilat janë parashtruar në Dokumentacionin e marrë nga Institucioni mbi “Planifikimin e aktiviteteve shkencore 2018-2019”.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik ka mbështetjen e Institucionit në kërkimin shkencor dhe pjesëmarrjen në projekte. Personeli akademik publikon vazhdimisht artikuj në revista shkencore, prezanton në konferenca të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, angazhohet në projekte, leksione të hapura, edukimin në vazhdim të studentëve me informacione bashkëkohore të përshtatura me programin e studimit.</p> <p>Pjesëmarrja e personelit akademik në këto veprimtari kërkimore-shkencore dhe rezultatet e studimeve të tyre janë kontribut në zhvillimin e shkencës dhe rrit shkallën e kualifikimit të stafit akademik.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka në përbërje të tij pedagogë, të cilët i kanë mbaruar studimet e tyre jashtë vendit dhe të aftë që të angazhohen në mësimdhënie në gjuhë të huaj, megjithatë Departamenti i Infermierisë dhe</p>

<p>mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Fizioterapisë deri tani nuk ofron mësimdhënie në gjuhë të huaj.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Bazuar në RVB, Institucioni aktualisht nuk organizon programe të kualifikimit të mëtejshëm. Për personelin akademik, i cili është i interesuar për kualifikime të mëtejshme brenda apo jashtë vendit, Institucioni ofron lehtësira dhe hapësira për realizimin e tyre.</p> <p><i>Megjithatë, duhet të rritet më tej angazhimi për të përfshirë personelin akademik në programe shkëmbimi apo projekte ndërkombëtare, në funksion të kualifikimit të stafit akademik dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies.</i></p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna në lidhje me aktivitetin kërkimor – shkencor të stafit të tij akademik të angazhuar në programet e studimit.</p> <p>Në dokumentacionin e marrë gjatë vizitës në Institucion disponojmë Formularet e vlerësimit të kërkimit shkencor, të cilat paraqesin në mënyrë individuale aktivitetin kërkimor-shkencor të pedagogëve të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë, në lidhje me botimet apo projektet kërkimore brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Të dhënat ruhen në departament dhe pranë Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akadematike.</p>



Konkluzionet e vlerësimit:

1. Pedagogët e angazhuar në mësimdhënie në Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë janë përfshirë në 4 projekte individuale, prej të cilave 3 ndërkombëtare dhe 1 kombëtare. Gjithashtu Departamenti ka organizuar gjatë viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, 2 Konferenca vjetore Kombëtare, 2 Konferenca Studentore, si dhe 4 leksione të hapura.
2. Në kuadër të “Edukimit në vazhdim”, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka planifikuar për vitin akademik 2018-2019 (tetor 2018 - qershor 2019) aktivitete kërkimore –shkencore për studentët që ndjekin studimet në Masterin Profesional “Infermieri Kirurgjikale” dhe ata të cilët kanë përfunduar studimet në këtë program studimi. Këto aktivitete janë në funksion të nevojave të profesionit të tyre duke synuar në rritjen e njohurive bashkëkohore dhe përmirësimin e cilësisë.
3. *Duhet të rritet më tej angazhimi për të përfshirë personelin akademik në programe shkëmbimi apo projekte ndërkombëtare, në funksion të kualifikimit të stafit akademik dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies.*

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.


Albanian University ka si prioritet kryesor bashkëpunimin me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit mbi baza të shkëmbimit të programeve, stafit akademik, organizimin e konferencave të përbashkëta, etj. Gjithashtu ka marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh të tjera brenda vendit, në respekt të forcimit të shkëmbimit edukativ ndërinstitucional dhe ka si fokus kryesor sigurimin e kushteve për kryerjen e praktikës profesionale të studentëve. Këto bashkëpunime janë një mjet i domosdoshëm për njohjen e ndërsjelltë të kulturave, për zhvillimin kulturor, shkencor të njohurive dhe shpërndarjen e tyre, për të nxitur zhvillimin e projekteve të përbashkëta me interes të ndërsjelltë në fushat e projektuara dhe disiplina të caktuara në drejtim të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Institucioni ka bashkëpunim me një sërë Institucionesh kombëtare si: Spitali Universitar i Traumës, Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Spitalet rajonale të rretheve si Fier, Berat, Qendra e Fizioterapisë “Halili”, etj.

Marrëveshjet e bashkëpunimit me Institucione Ndërkombëtare si: Universiteti i Pizës, Universiteti Federico II i Napolit, Universiteti Aquilas, Itali realizojnë shkëmbimin e personelit akademik si edhe realizimi i projekteve kërkimore të përbashkëta.



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e marrë nga Institucioni dëshmohej për një marrëdhënie të gjerë bashkëpunimi të Institucionit me një sërë Institucionesh të tjera Kombëtare dhe Ndërkombëtare, si spitale shtetërore dhe klinika private, në kuadër të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve që kryejnë studimet në FSHM, njohjen e drejtpërdrejtë të tyre me tregun e punës dhe testimin e parë të aftësive në planin praktik, si dhe me Institucione të arsimit të lartë, në kuadër të shkëmbimit të personelit akademik, eksperiencave dhe realizimit të projekteve të përbashkëta.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Në rregulloren e FSHM dhe rregulloren e Departamentit, të dhënë nga Institucioni janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar detyrat e stafit, e cila është një faktor shumë i rëndësishëm në marrjen e përgjegjësive të gjithsecilit, bashkëpunimit për një ecuri të mirë të programeve të studimit, kërkimit shkencor, aktiviteteve ekstrakurrikulare dhe kryerjen e analizës së vazhdueshme për atë çfarë është arritur dhe çfarë pritet të realizohet prej secilit.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>Marrëdhëniet e frytshme të bashkëpunimit që Institucioni ka vendosur me spitale shtetërore dhe klinikat private në kuadër të praktikave profesionale, sipas programit të studimit janë një pikë e fortë e këtij Institucioni.</p> <p>Për mbikëqyrjen e praktikës së studentëve spitale dhe klinikat përcaktojnë një udhëheqës, i cili kontrollon dhe informon mbi ecurinë e praktikës së studentëve.</p>

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtjshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Albanian University ka marrëdhënie bashkëpunimi me një sërë Institucionesh të tjera, si spitale shtetërore dhe klinika private, të cilat i mundësojnë Departamentit të Fizioterapisë dhe Infermierisë të realizojë praktikat profesionale për studentët që ndjekin ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.
2. Gjithashtu marrëdhëniet e bashkëpunimit të AU me Institucione të tjera të arsimit të lartë janë në funksion të shkëmbimit të eksperiencave, kulturave, personelit akademik dhe realizimit të projekteve të përbashkëta.

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Programi i studimit Mp në “Infermieri Kirurgjikale” është në përputhje me standardet kombëtare si dhe misionin dhe objektivat strategjike të AU ;
2. AU ndjek procedura të përcaktuara qartë përsa i përket punëmarrjes së një personeli akademik efektiv dhe me kontratë cilësor;
3. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë plotëson kriteret si për personelin akademik në total, ashtu edhe për kërkesat në lidhje me kualifikimin e tij.
4. Infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor për programin e studimit plotëson standartet dhe kriteret e cilësisë;
5. Departamenti në bashkëpunim me NJSBC është i angazhuar në vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së stafit akademik dhe atij administrativ;
6. “Manuali i Studentit” dhe “Udhëzuesi për Zhvillimin e Karrierës” që Institucioni ve në dispozicion të studentëve për këtë program studimi janë instrumente mjaft të vlefshme për ta;
7. Realizimi i një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera, si spitale shtetërore dhe klinika private, që mundësojnë realizimin e praktikës profesionale të parashikuar për programin e studimit;

b. Pika të dobëta:

1. Projektet kërkimore janë akoma në numër të pakët, kërkohet më shumë angazhim dhe mbështetje financiare për kërkimin shkencor;
2. Literatura jo e mjaftueshme në përputhje me lëndët kurrikulare për këtë program studimi;

c. Mundësitë:

1. Të rishikohen syllabuset, kryesisht përsa i përket përzgjedhjes së literaturës së rekomanduar dhe rishikimin e emërimit të lëndëve/moduleve nga ana e pedagogëve;
2. Rritja e bashkëpunimit me institucionet homologe universitare jashtë vendit me qëllim shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve si dhe në drejtim të kërkimit shkencor;
3. Zgjerimi i partneritetit kombëtar dhe ai ndërkombëtar;
4. Rritja e botimeve në këtë fushë;

d. Pengesat:

1. Mungesa e eksperiencës së stafit akademik në aplikime në projekte;
2. Mbështetja financiare e zhvillimit të kërkimit shkencor, por duke patur të ardhura vetëm nga tarifat e studimit sjell një pengesë;

Rekomandime:

- Të rritet më tej angazhimi për të përfshirë personelin akademik në programe shkëmbimi apo projekte ndërkombëtare, në funksion të kualifikimit të stafit akademik dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies.
- Të përditësohet literatura në përputhje me lëndët kurrikulare.

II. SWOT ANALYSIS

a. Strengths:

1. Study Program Professional Master in “Nursing in Surgery” is in fully compliance with National Standards, as well as the mission and strategic objectives of Albanian University;
2. Albanian University AU follows clear defined procedures regarding employment of academic effective staff and academic contracted staff;
3. The Department of Nursing and Physical Therapy fully complies the criteria for academic staff in total, as well is in accordance with the requests related to its qualification;
4. The infrastructure, which is disponsible of teaching process in this study program, fully fulfills standards and quality criteria;



5. The department in collaboration with NJSBC (the unit OF Internal Assurance of Quality) is engaged in continuous evaluation of the performance of academic staff and administrativ one;
6. “Student Manual” and “The guidelines for Carrier Development”, which are prone to the students from the University for this study program, are valuable instruments in their hands;
7. The fulfillment of many collaborations with other institutions like as: governmental hospitals and private clinics , open the possibility of professional practice implementation in this study program;

b. Weaknesses:

1. Research Projects are still in low numbers, and for this is still needed more engagement and efforts;
2. The literature seems to be not sufficient in accordance with curricular subjects for this study program;

c. Opportunities :

1. Review the syllabi, above all selection of recommended literature, as well as review of designation of subjects/ modules (lecturer’s part);
2. The empowerment of collaboration with homologous university institutions outside the cuntry with aim of staff and student exchange towards scientific research;
3. Escalation of national and international partnership;
4. Increase of publications in this fjeld;

d. Threats:

1. The lack of experience of aacademic staff in applications and in projects;
2. Financial support of scientific research(it is really an obstacle having money only from the students fees;

Recommendations:

- *To update the literature in compliance with curricular subjects*
- *To better increase the engagement of academic staff in exchange programs , international programs academic staff increasing the quality of teaching.*

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Asoc. Dr. Manika KREKA
Dr. Brizida REFATLLARI

